

Komisioni i Disiplinës VENDIM Nr. 2

9 shkurt 2024

Më datë 9 shkurt 2024 u mbledh Komisioni i Disiplinës i Federatës Shqiptare të Basketbollit, nën drejtimin e kryetarit, z. Klevis Kaso, me praninë e anëtarëve, z. Franko Bushati dhe z. Klaudio Ndoja, për trajtimin e problematikës të hasur gjatë ndeshjes Vllaznia – Tirana NEPTUN, java XIII-të e kampionatit kombëtar meshkuj të rritur, data 4 shkurt 2024, pallati i sportit “Qazim Dervishi”, Shkodër.

Në relacionin e Vëzhguesit të ndeshjes paraqitet situatë e tensionuar në fillim të periodës së III-të, ku tifozeria e ekipit pritës ka hedhur sende në fushën e lojës, duke çuar në ndërprerjen e përkohshme të ndeshjes derisa janë shtuar forcat e sigurimit. Më pas ndeshja ka vijuar deri në përfundim me rivalitetet sportiv dhe në kushte normale të siguruar nga forcat e shtuara të policisë.

Për sa mësipër, Komisioni i Disiplinës pasi trajtoi materialet përkatëse për shqyrtim,
Vendosi:

1. Sanksion financiar në vlerën 30'000 lek për shoqatën Vllaznia, bazuar në rregulloren e aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 13.8, *“Sanksionet ndaj organizatorëve të ndeshjes për sjelljet josportive të publikut”, pika ç, “Hedhje e objekteve të rrezikshme në fushën e lojës, para, gjatë ose pas ndeshjes (pa u larguar ekipet dhe gjyqtarët), në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare.”*
2. Tërheqje vëmendje shoqatës Vllaznia për marrjen e masave të sigurisë në ndeshjet e organizuara si ekip pritës, duke siguruar realizimin e tyre në kushtet optimale sportive, si dhe në rast përsëritje, FSHB do të jetë e detyruar të përshkallzojë masën disiplinore bazuar në rregulloren e aktiviteteve kombëtare të basketbollit.

Në bazë të rregullores së aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 11.8, kundër vendimeve të mësipërme mund të apelohe brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit.



Klevis Kaso
Kryetar



Franko Bushati
Anëtar



Klaudio Ndoja
Anëtar